



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 25

Datë: 04. 03. 2021.

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Valdete Daka, kryetare e KQZ - së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Arianit Elshani, Alim Rama, Eshref Vishi, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**
- 2. Raport i Këshillave të KQZ-së**

Këshilli për Çështje Ligjore;

-Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në: Lipjan dhe Vushtrri

3.Të ndryshme.

-
- 1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

Valdete Daka: E hapim mbledhjen e 25-të të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. A ka dikush vërejtje në këtë rend dite? Kush është për aprovim? Miratohet rendi i ditës...Atëherë, raporti i këshillave konkretisht këshilli për çështje ligjore.

2.Raport i Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Çështje Ligjore;

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në: Lipjan dhe Vushtrri

Arianit Elshani: Këshilli për çështje ligjore në mbledhjen e mbajtur sot, ka shqyrtuar dy kërkesa për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendit komunal, një në Vushtrri dhe tjetrën në Lipjan. Pas kalimit të të gjitha filtrave ligjor duke filluar nga zyrtari I lartë komunal në komunat përkatëse, të dy kërkesat kanë respektuar të gjitha filtrat, realisht të rregulloreve dhe ligjit në fuqi dhe pas këtij rekomandimi këshilli për çështje ligjore ka aprovuar dhe rekomandon edhe KQZ-në që të aprovoj këto dy kërkesa për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendit komunal. Për sqarim nuk ka ndonjë kuotë, ndonjë grua d.m.th të tejkaluar sipas kërkesës së Z.Kurteshi kështu që rekomandoj që të aprovohen edhe këtu.

Valdete Daka: Atëherë, kush është që Fitim Shala të emërohet anëtarë I kuvendit komunal në Lipjan nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës duke zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal Nehat Tërpeza. Kush është për? Kush është për, që Agim Krasniqi të emërohet anëtarë I kuvendit komunal në Vushtrri nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës duke zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal Fisnik Gërguri. Kush është për? Miratohet...

Këto ishin pra, dy pika për të cilat u dakorduan që ti përfundojmë meqenëse ishin sot, nuk kemi pika tjera. Sic e dini na tash I presim ankesat eventuale në PZAP deri në ditën e nesërme në orën 11:25 –të dhe pas asaj shohim se çfarë vendimi do të na jepni.

3 Të ndryshme !